

ENNA Geo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime, Kroaci do të fitojë kontroll mbi IGeoPen d.o.o. për tregti dhe shërbime, Kroaci

(lënda nr. 08-90/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 20.05.2026, ndërsa e plotësuar më 22.05.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin ENNA Geo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime, me seli në adresën Zona Ekonomike Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, do të fitojë kontroll mbi IGeoPen d.o.o. për tregti dhe shërbime, me seli të regjistruar në adresën rruga Drenovačka 3, Zagreb, Kroaci, përmes shitblerjes së pjesëve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

ENNA Geo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime merret me zhvillimin dhe investimin në impiante për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, siç është energjia gjeotermale, dhe është pjesë e grupit ENNA. ENNA është investitor lider dhe një nga grupet investuese me rritjen më të shpejtë në Kroaci, i cili është i përkushtuar në ofrimin e zgjidhjeve inovative që nxisin transformimin e gjelbër dhe krijojnë vlerë afatgjatë për partnerët dhe komunitetin, si në sektorin e energjisë, ashtu edhe në sektorin e transportit, përkatësisht logjistikës.

ENNA Geo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime është në pronësi 100% të ENERGIJA NATURALIS d.o.o. për investime dhe menaxhim, e cila është në pronësi të shoqërisë SUSTAINABLE SOLUTIONS HOLDING AG, pronari i së cilës përsëri është personi fizik PV.

PV është pronar përfundimtar edhe i grupit FORTENOVA, i cili është i pranishëm në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime MERCATOR MAKEDONIJA SHPKNJP Shkup në likuidim, me NUAS 5938848 dhe seli në rr. Ognjan Prica nr. 1/3-28 mezanin, Shkup Kisella Vodë, me veprimtari prioritare të regjistruar: Tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, kryesisht me ushqim, pije dhe duhan. MERCATOR MAKEDONIJA SHPKNJP nuk është në mënyrë komerciale aktive dhe është në procedurë të likuidimit.

Grupi ENNA dhe grupi FORTENOVA së bashku quhen "Grupi PV". Grupi PV ka të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shitjes së produkteve ushqimore siç janë vajrat ushqimorë, margarinat, majonezat, ujërat minerale dhe lëngjet, salcat dhe shurupet, dhe produktet e mishit të tharë.

IGeoPen d.o.o. për tregti dhe shërbime është themeluar me qëllimin ekskluziv të zhvillimit, ndërtimit dhe menaxhimit të impianteve gjeotermale dhe në këtë drejtim zhvillon tri projekte gjeotermale në Ernestinovo, Sjeçu dhe Pçeliq.

IGeoPen d.o.o. për tregti dhe shërbime nuk ka prani në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të ardhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit, parashtruesi i njoftimit propozon që si treg përkatës i produkteve të përcaktohet tregu për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit preliminar, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose përmes e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë pranë Komisionit në afat prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

02.06.2026

Shkup